



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME

ARJ.nr.59/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Beshir Islami dhe Nenad Lazić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Av.Arbër Istrefi BI, me seli në Prishtinë, Rr. “.....”, hyrja nr....., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me seli në P., me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të organit të paditur nr.201/2019 të datës 24.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditurës, ATK, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.923/22 të datës 18.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17 Janar 2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në P., ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.923/22 të datës 18.05.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.923/22 të datës 18.05.2023, është vendosur si në vijim: Refuzohet si e pa bazuar ankesa e te paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, e datës 30.11.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1815/19, i datës 07.10.2021, Vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.923/22 të datës 18.05.2023, e paditura, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes së të drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.923/22 të datës 18.05.2023, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-

Divizioni Fiskal, A.nr.1815/19, i datës 07.10.2021, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, apo, Mbetet në fuqi vendimi i të paditurës ATK nr.201/2019 i datës 24.06.2019.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala paditëse.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditurës dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës ATK nr.201/2019 të datës 24.06.2019, Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit me nr.201/2019 të datës 08.05.2019 ndërsa Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me Raportin e Kontrollit të lëshuar nga ATK-Drejtoria Rajonale Prishtina 1, janë vërtetuar si të bazuara.

Kundër vendimit të lartë cekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.1815/19, të datës 07.10.2021, në dispozitiv të tij ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadi e paditësit “Avokat Arber Istrefi” BI me seli, P., Rr. “B. K” Hyrja nr....., Kati ANULOHET Vendimi nr.201/2019 të datës 24.06.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës-Divizioni i Ankesave. III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës që paditësin “Avokat Arber Istrefi” BI me seli Prishtinë, Rr. “.....”, Hyrja, ta liroj nga qarkullimi dhe tatimi shtesë për të gjitha llojet e tatimit që kanë rezultuar nga deponimet bankare të paditësit në shumën prej 16,000.00€, të deponuara me datë 16.08.2014, në shumën prej 13,700.00€ të deponuara me datë 27.08.2014, si dhe shumën prej 6,700.00€ të deponuara me datë 30.08.2014, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së ketij aktgjykimi. IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se; Nga provat e administruara gjatë kësaj procedure të konfliktit administrativ është provuar se paditësi, respektivisht pronari i paditësit për mjetet e deponuara në llogarinë e tij personale bankare në “Raiffeisen Bank”, me nr., në datën 16.08.2014 në shumë prej 16,000.00€, në datën 27.08.2014 në vlerë prej 13,700.00€ si dhe në datën 30.08.2014 në vlerë prej 6,700.00€, apo në total në shumën prej 36,400.00€, me përshkrimin bankar “deponim për blerjen e banesës”, ka dëshmuar origjinën e pa tatueshme të këtyre mjeteve. Kjo nga ana e paditësit sipas vlerësimit të gjykatës është dëshmuar nga urdhërpagesat për para të gatshme të lëshuara nga banka “Procredit Bank” në Republikën e Maqedonisë tani Republika e Maqedonisë së Veriut të datës 15.08.2014, 27.08.2014, dhe ajo e datës 29.08.2014, të cilat u administruan si prova nga gjykata, nga ku u vërtetua fakti se prindi i këtu paditësit, Zaim Istrefi në këto data, ka tërhequr mjetet financiare nga llogari personale e

kursimeve në “Procredit Bank” në Strugë në Maqedoni, në denar maqedonas në shumat 1,000,000.00, 600,000.00, 250,000.00 dhe 400,000.00, shuma këto të cilat pas përlogaritjes dhe konvertimit nga denari në euro, sipas kursit valutor në datat kur janë tërhequr mjetet financiare, nga ana e ekspertit financiar janë konstatuar se janë në vlerën e përgjithshme prej 36,586.26€. Gjykata kësaj ekspertizë financiare ja fali besimin sa i përket konstatimeve përkitazi me përlogaritjen dhe konvertimin e mjeteve financiare të tërhequr nga prindi i pronarit të paditësit nga llogaria tij bankare në “Procredit Bank” në Maqedoni në datat 15.08.2014, 27.08.2014 dhe 29.08.2014 sepse ekspertiza i përmbante elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale. Gjykata konstaton se paditësi në procedurë administrative tek e paditura, por edhe në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ ka dëshmuar origjinën e pa tatueshme të mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej 36,400.00€, shumë kjo të cilën e paditura pa të drejtë e ka trajtuar si qarkullim shtesë për paditësin për vitin 2014, edhe përmes dëshmime tjera relevante siç janë kopjet e pasaportave të pronarit të paditësit dhe kopjet e pasaportave të dy prindërve të pronarit të paditësit nga ku gjykata gjeti se të njëjtit në datën 15.08.2014, datë kjo kur babai i pronarit të këtu paditësit ka tërhequr mjetet financiare në shumë prej 1,000,000.00 denar apo të llogaritura në euro në shumë prej 16,258.84€, nga llogaria e tij bankare në “Procredit Bank” në qytetin e Strugës në Maqedoni, kanë kaluar kufirin Maqedoni-Kosovë, dhe këto mjete sipas pretendimit të paditësit janë sjell në Kosovë, pasi që të njëjtat janë shpërndarë në mes tyre, në mënyrë që të njëjtat të mos deklarohen në kufi, për faktin se sipas vendimeve të lartcekura të Qeverisë së Maqedonisë rezidente dhe jo rezidente nga Maqedonia kanë mundur të eksportojnë mjete financiare nga Republika e Maqedonisë së Veriut para të huaja apo çeqe vetëm në vlerën deri në 10.000,00€, po jo më shumë.

Gjykata këtë pretendim të palës paditëse e mori si të besueshëm dhe të bazuar në fakte, për arsye se, me asnjë dispozitë të legjislacionit në fuqi nuk është e ndaluar që mjetet financiare me rastin e kalimit të kufirit të mund të shpërndahen në mesin e udhëtarëve që udhëtojnë bashkërisht në automjetin e tyre si në rastin konkret. Në këtë drejtim gjykata thekson se, edhe me dispoziten e nenit 29 Qarkullimi i mjeteve monetare brenda dhe jashtë Kosovës - Detyrimi për të deklaruar, par.I të Ligjit nr. Nr. 03/L-196 për parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar ky me Ligjin nr.04/L-178, është përcaktuar se *“1. Secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës, para nëpunësit të autorizuar të doganës dhe nëse kjo kërkohet nga nëpunësi, ai duhet ti paraqesë këto mjete monetare. Sipas këtij neni, konsiderohet se personi bart mjete financiare nëse, midis të tjerash, ato janë në posedim fizik të këtij person apo në automjetin privat ose në ndonjë mjet transporti tjetër që shfrytëzohet nga ky person. Detyrimi për të deklaruar nuk konsiderohet i përmbushur nëse informatat e ofruara janë të pasakta apo jo të plota”*. Pra në kuptim të drejt të kësaj dispozite ligjore shihet që obligimi për deklarim të mjeteve monetare qoftë në dalje apo në hyrje në Kosovë në formën e caktuar në Doganën e Kosovës duhet të bëhet për secilin person i cili hyn apo del dhe bartë shuma monetare mbi 10.000.00, por ky detyrim nuk është edhe për shumat nën 10,000.00€.

Arsyetimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar sipas të cilit kontesti i tatimpaguesit për trajtimin e deponimeve bankare të trajtuara si shitje nga kontrolli nuk mund të pranohet në bazë të pretendimeve se janë deponime nga mjetet e tërhequra nga prindi jashtë, pasi që i njëjti nuk ka ofruar fakte bindëse për të arsyetuar kontestin e tij, ngase nuk janë kryer transferet e mjeteve mes llogarisë bankare (Maqedoni-Kosovë), dhe se nuk janë transaksione të kryera të mjeteve të njëjta përmes llogarisë bankare mes personave në fjalë, për gjykatën nuk ka bazë të qëndrueshme juridike dhe faktike, për arsye se, në radhë parë në rastin konkret transferimi i mjeteve financiare nuk ka ndodhur në mes dy bizneseve, çka po të kishte ndodhur do të kishte bazë ky konstatim i të paditurës, bazuar në nenin 13.7 të Ligjit nr.03/L-222, ku parashihet që çdo transaksion mbi pesëqind euro i bërë në mes të personave të përfshira në aktivitet ekonomik pas 1 janarit të vitit 2009 kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare, por në këtë rast tërheqja e mjeteve financiare ka ndodhur nga prindi i pronarit të paditësit nga llogaria e tij bankare në Maqedoni dhe më pastaj këto mjete janë sjell në Kosovë nga anëtarët e familjes, pronari i këtu paditësit, babai dhe nëna e tij, pastaj në radhë të dytë siç gjykata theksoj edhe më lartë transferimi i mjeteve-eksportimi i tyre nga Republika e Maqedonisë nuk ka mundur të bëhet për mjetet në vlerë mbi 10,000.00€, sipas vendimeve respektive të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sa i përket arsyetimit të paditurës se paditësi gjithashtu nuk ka argumentuar hyrjen-daljen e mjeteve financiare përmes kufirit Maqedoni-Kosovë, përderisa mjetet janë tërheq nga banka në Maqedoni në emër të një personi dhe si të tilla duhet të lajmërohen, gjykata vlerëson se edhe ky konstatim i të paditurës nuk është i bazuar, sepse bazuar në vendimet e përmendura të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në nenin 29 të Ligjit nr. Nr. 03/L-196 për parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar ky me Ligjin nr.04/L-178, si ligj i aplikueshëm në këtë rast nuk ka ekzistuar obligimi që për mjetet e eksportuara nga rezidenti ose jo rezidenti nga Maqedonia, në shumat deri në 10.000.00€, të deklarohen në kufi, siç nuk ka ekzistuar obligimi që personi i cili hyn të Kosovë të deklaroj para autoriteteve përkatëse shumën nën 10,000.00€. Ky obligim për deklarimin e mjeteve monetare me rastin e hyrjes në Kosovë ka ekzistuar vetëm për personin i cili bartë mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë 10.000.00€, por jo edhe më pak, siç ka ndodhur në këtë rast nga ana e pronarit të këtu paditësit dhe prindërve të tij, të cilët kanë mundur që mjetet financiare ti ndajnë në mes tyre me rastin e kalimit kufitar, duke pasur parasysh fillimisht ndalesën në shtetin e Republikës së Maqedonisë për eksportim të mjeteve jashtë vendit mbi 10,000.000€ nga ana e rezidentëve apo jo rezidentëve në këtë vend si dhe obligimin ligjor në Kosovë që secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) Euro apo më shumë duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës. Rrjedhimisht, gjykata erdh në përfundim se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se e paditura nuk ka vepruar drejt dhe sipas ligjit kur paditësin e ka ngarkuar me qarkullim dhe tatim shtesë për mjetet financiare në shumën e përgjithshme prej 36,400.00€, për vitin 2014, për të gjitha llojet e tatimit, sepse paditësi ka dëshmuar me prova të mjaftueshme origjinën e pa tatueshme të këtyre mjeteve financiare, siç kërkohet me dispozitën e nenit 30 par.3 pika 3.2.2 të UA nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222, andaj gjykata në përputhje me dispozitat e nenit 46 par. 4 të LKA-së,

vendosi që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, të anuloj vendimin e ATK-së me nr.201/2019 të datës 24.06.2019, si në dispozitivin e dytë të këtij, ndërsa në dispozitivin e tretë të aktgjykimit e obligoj të paditurën që ta liroj paditësin nga qarkullimi dhe tatimi shtesë për të gjitha llojet e tatimit që kanë rezultuar nga deponimet bankare të paditësit në shumën prej 16,000.00€ të deponuara me datë 16.08.2014, në shumën prej 13,700.00€ të deponuara me datë 27.08.2014, si dhe shumën prej 6,700.00 të deponuara me datë 30.08.2014. Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe dispozitat e nenit 46 par.2 dhe 4 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit. Andaj, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimin të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditurës dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala e paditur në kërkesën e saj. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimin të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i ankesave, nuk është vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë vlerësuar se e paditura pa të drejtë e ka ngarkuar paditësin me qarkullim dhe tatim shtesë, i cili ka rezultuar nga deponimet bankare të paditësit në shumën e përgjithshme prej 36,400.00€, për vitin 2014, sepse paditësi ka dëshmuar me prova të mjaftueshme origjinën e pa tatueshme të këtyre mjeteve financiare, ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 30 par.3 pika 3.2.2 të UA nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222.

Gjykata shqyrtoj pretendimet e parashtruara si kërkesë dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkelje të dispozitave të procedurës apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe vlerësoj se pretendimet e njëjta, se tranferet e mjeteve nuk janë bartur nga llogaria e prindit në llogari bankare të paditësit ,pastaj se mjetet e tërhequra nuk janë paraqitur në kufi sipas kërkesave ligjore, etj., dhe vlerëson se këto pretendime të njëjta të paraqitura, janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara, të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara, për një vendosje ndryshe në këtë çështje nga çka kanë vendosur gjykatat e instancave më të ulëta, sepse në gjykatat e instancave më të ulëta paditësi ka dëshmuar me prova të mjaftueshme origjinën e pa tatueshme të këtyre mjeteve financiare, siç kërkohet me dispozitën e nenit 30 par.3 pika 3.2.2, të UA nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222, e po ashtu në rastin konkret transferimi i mjeteve financiare nuk ka ndodhur në mes dy bizneseve prej nga do të kishte bazë ky pretendim i të paditurës, bazuar në nenin 13.7 të Ligjit nr.03/L-222, ku parashihet që çdo transaksion mbi pesëqind euro i bërë në mes të personave të përfshira në aktivitet ekonomik pas 1 janarit të vitit 2009, kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, LATP-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, lidhur me mënyrën e vendosjes dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nga e paditura si në vendimin e saj nr.201/2019 të datës 24.06.2019, është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Nga parashtrimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1., të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.59/2024, më datë 17 Janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani